



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, neneve 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 të datës 27.12.2006 dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2015, miratoi,

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Miratohet kërkesa e z. Sabit Halitit nga Podujeva, për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërive të evidentuara sipas ngastrave kadastrale nr. 607-4, 612-14, 612-5 dhe 612-7, kultura – arë, kl. 1 vendi i quajtur Jazi në sipërfaqe prej 0.21.08 m², Zona kadastrale Obrancë, certifikata nr. 08/095/1583/2015 të datës 13.01.2015.

Neni 2

Investitori obligohet që paluajtshmëritë përkatëse ta shfrytëzojë për ndërtimin e objektit afarist.

Neni 3

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bëjnë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 01-350-16494 i datës 4 shkurt 2015, për shkak se në të njëjtin, bazuar në kopjen e planit, gabimisht është përfshirë edhe një ngastër tjetër.

Neni 7

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-350-16494-1
Podujevë,
27 shkurt 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi